

VENDIM
Nr.290, datë 12.3.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA DAJÇ TË QARKUT TË SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Dajç të qarkut të Shkodrës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 9 (nëntë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Dajç për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU										
Komuna: Dajç										
Nr.	Numri pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullimore (EPK) Shtrirja gjeografike EPK	Emërtesa e ngastrës vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Nr. ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhënat e tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	36	Dajç-Velipoje	Argjinatura e Mushanit	46	P.Mbrojtjes	2	Për mb.tokave	MMPAU	Komuna	
2	37	“	Rrenoja	47	Bimësi Pyjore	7	“	“	“	
		“	Rrenoja	48	Bimësi Pyjore	15	“	“	“	
		“	Rrenoja	49	Bimësi Pyjore	6	“	“	“	
3	38	“	Kryeada e Shirqit	50	Bimësi Pyjore	36	“	“	“	
4	39	“	Argjinatura e Shirq	51	Bimësi Pyjore	16	“	“	“	
5	40	“	Uerrela	52	P.Mbrojtjes	4	Për pr.l.Drusore	“	“	
6	41	“	Stac.Urrela	53	Bimësi Pyjore	17	“	“	“	
7	43	Velipojë-Mali Kolaj	Gjymti	3	Kullote	49	Kullote	“	“	Dorëzuar sipas VKM Nr.700
8	44		Gjymti	4	Kullote	64	Kullote	“	“	
9	45	“	Gjymti	5	kullote	37	Kullote	“	“	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
36-41	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
43-45	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi